



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/Opstina Drgas



-Komisioni për Vlerësim të Ankandit Publik

01 Nr. 604/09-27872

Dt.25.10.2019

D r a g a s h

Në bazë të nenit 58.h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28 e dt.15.06.2008, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1. të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme të Komunës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.10/2019, prill 2019) dhe nenit 56 të Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 të dt.11.09.2008), bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal të Dragashit 01 Nr.060/01-16804/7 të dt.30.07.2019, Komisioni Komunal për Vlerësim, i themeluar me Vendimin e Kuvendit Komunal-Dragash 01 Nr.060/01-246574/2 të dt.26.09.2019, pas shqyrtimit paraprak, në mbledhjen e dt.18.10.2019, SHPALL këtë:

ANKAND PUBLIK

Për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të pronës së paluajtëshme të Komunës-lokalit prej 20 m/2 (byffe), në ndërtesën e Kuvendit Komunal-Dragash

- I. Pjesëmarrës në Ankand Publik mund të janë personat fizik e juridik të Komunës së Dragashit të cilët i kanë të kryera obligimet ndaj Komunës.
- II. Lokali, për shfrytëzim të përkohshëm, jepet **për periudhë 4 (katër) -vjeçare.**
- III. Lokali është i tipit të mbyllët (me destinacion-byffe), për nevojat e punëtorëve dhe palëve që u drejtohen organeve të Kuvendit Komunal-Dragash.
- IV. Fituesi i Ankandit, në lokal ofron kafe dhe pije tjera jo alkoolike, ndërsa, për lokalin shfrytëzues, nuk i nënshtohet pagesës së shërbimeve: qirasë, energjisë elektrike dhe ujit, por me çmime më të volitshme të shërbimeve se sa në restaurante dhe krijimin e kushteve më të mira të shërbimeve.
- V. Çmimi i përcaktuar fillestar për pjesëmarrje në Ankand është **50,00 (pesë dhjetë) euro**, duke u paguar **10,00 (dhjetë) euro**, pa kthim, me rastin e aplikimit.
- VI. Kriter kryesor i fitimit të Ankandit Publik është- çmimi më i lartë.
- VII. Ankandi mbetet i hapur 30 ditë nga data e publikimit në web-faqe dhe tabelën e shpalljeve të Komunës-Dragash, përkatësisht **deri më 25 Nëntor 2019, në ora 12,00.**
- VIII. Pas shqyrtimit të kërkesave-aplikimeve, të adresuara Komisionit për Vlerësim (që merren e dorëzohen-të mbyllura në pliko e pa emër, në Arkivin-Zyren e Pritjes të Komunës në Dragash), do të bëhet Njoftimi Publik nga ana e Komisionit në web faqen dhe tabelën e shpalljeve të Komunës së Dragashit.
- IX. Palët e paknaqura kanë të drejtën e Ankesës Komisionit për Ankesa të Kuvendit Komunal Dragash, në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të Njoftimit Publik.
- X. Pas përfundimit të të gjitha procedurave të Ankandit Publik, me fituesin, nënshkruhet Kontrata, për kushtet e posaçme të shfrytëzimit të lokalit dhe shërbimeve që ofrohen.

Kryetari i Komisionit

Granit Rifaj



Kryetari Komunes

Shaban Shabani